



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS / OPŠTINA DJAKOVICA
MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të nenit 28.2 të Ligjit nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 4.2 të Rregullores nr. 06/10 për transferimin e nëpunësve civil, Kryetarja e Komunës së Gjakovës në mbështetje të autorizimeve të përcaktuara me nenin 58.1 (f) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe nenit 41.1 (f) të Statutit të Komunës së Gjakovës, me datën 24.03.2016 merr këtë:

AKTVENDIM

Për transferimin e përkohshëm të nëpunësve civile si masë jodisciplinore

1. Nëpunësja civile Znj. Teuta Vokshi, nga vendi I punës Udhëheqëse e sektorit të gjendjes civile në Drejtorinë Për Punët e Përgjithshme Administrative, transferohet në vendin e punës Udhëheqëse e Sektorit të Arsimit pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit, Gjakovë.
2. Vendi I ri i punës është i të njëjtës grade sikurse vendi I mëparshëm. Paga në vendin e ri të transferuar është identike me pagesën si në vendin e mëparshëm e përlogaritur me koeficientin 7.5.
3. Nëpunësja civile Znj. Teuta Vokshi duhet t'ia fillon punën në vendin e ri me datën 25.03.2016 dhe e përfundon me datën 25.03.2017.
4. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në nevojën urgjente të Institucionit për plotësim të vendit të punës: Udhëheqës i Sektorit të Arsimit, e duke pasur parasysh nevojën e ngritjes profesionale të personelit pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit të Komunës së Gjakovës, Kryetarja e Komunës vendosi si në dispozitë të këtij Aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, nëpunësja civile ka të drejtë ankese si pas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

I dorëzohet:

Punëtores: z. Teuta Vokshi
Drejtorisë Komunale të Arsimit
Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative
Zyrës së Personelit
Arkivit Komunale

Kryetarja e Komunës së Gjakovës

znj. Mimoza Kusari – Lila

